

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – SHËRBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **Objekti i procedurës:** “Sigurimi i infrastrukturës për ofrimin e shërbimit të Informacionit të Fluturimit në Aeroportin e Kukësit përfshirë pajisjet e nevojshme”.
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (F.P.P.):** 34962100-9 Pajisje kontrolli të trafikut ajror; 34942000-8 Pajisje për kullën e kontrollit

Vlera e fondit limit: 33 122 400 (tridhjetë e tre milion e njëqind e njëzet e dy mijë e katërqind) **lekë pa T.V.SH.**, ose 343 024 (treqind e dyzet e tre mijë e njëzet e katër) **Euro pa TVSH.** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 19/12/2025 është 96.56 Lekë/Euro.

- Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor ALBCONTROL SHA ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të V.K.M.-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Neni 83 i L.P.P. “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, si dhe,

Neni 82 pika 1, i L.P.P: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022,2023,2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e L.P.P., si dhe nenin 43, të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuari ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve: 2022, 2023, 2024 të të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 të ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin emnistrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar. Janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- **ISO 9001: 2015** “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”
- **ISO 27001:2022** “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”
- **ISO 20000-1:2018** “Sistemi për Menaxhimin e Shërbimeve”

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, ose ekuivalente me to.

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 44 të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve. Çertifikata duhet të

jetë lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

ISO 27001:2022 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit” - është thelbësor, pasi siguron zbatimin e sigurisë së informacionit që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standardet ndërkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës. Certifikata duhet të jetë lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

ISO 20000-1:2018 “Sistemi për Menaxhimin e Sherbimeve” - Ky standard specifikon kërkesat për një organizatë për të krijuar, zbatuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar vazhdimisht një sistem të menaxhimit të shërbimit (SMS). Kërkesat e specifikuara në këtë dokument përfshijnë planifikimin, projektimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve për të përmbushur kërkesat e shërbimit dhe për të ofruar vlerë dhe që kërkon siguri në lidhje me cilësinë e këtyre shërbimeve.

Sqarojmë se ALBCONTROL SHA, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane 1035/2011 dhe të audituar nga ana e Agjensisë Europiane të Sigurisë së Aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohë sistemet me të cilët operon duhet të jenë kompatibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtare të Aviacionit Civil sipas Rregullores se Komisionit Europian EC 552/2004 si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative.

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e projektit dhe në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, sipas tabelës në specifikimet teknike, e cila duhet të përmbajë:

- Modelin e Kullës që do të ofrohet (shoqëruar me katalogët përkatës);
- Modelin e sistemeve CNS që do të ofrohet.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 6 të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Albcontrol sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë ofertën teknike në përputhje me specifikimet teknike.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë pronësinë ose të drejtën për përdorimin e pajisjes (Kullë e kontrollit mobile) për ofrimin e këtij shërbimi. Dokumentet provuese për disponimin e kullës së kontrollit mobile janë fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontrate dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe renditur i pari duhet të dorëzojë pranë A.K., përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.5. Operatorët ekonomikë për realizimin e kontratës duhet të kenë të punësuar jo më pak se 5 (pesë) punonjës (prej të cilëve të jenë inxhinierët e mëposhtëm) për 3 tre muajt e fundit, kjo e vërtetuar nga Administrata Tatimore dhe shoqëruar me listepagesat për periudhën e mësipërme:

- a) Të paktën 1 (një) inxhinier informatik
- b) Të paktën 1 (një) inxhinier elektronik;
- c) Të paktën 1 (një) inxhinier teknologji informacioni
- d) Të paktën 1 (një) inxhinier mekanik
- e) Të paktën 1 (një) inxhinier elektrik

Kërkesat e mësipërme duhen të vërtetohen me:

- Kontratë punë përkatëse
- Diplomat përkatëse
- Listëpagesat sipas formatit E-Sig 25, të konfirmuara nga Administrata Tatimore që vërtetojnë se punonjësi ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik 3 (tre) muajt e fundit.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe renditur i pari duhet të dorëzojë pranë A.K., përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. ALBCONTROL SH.A, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Për të garantuar eksperiencën e stafit të operatorit ekonomik pasi kemi të bëjmë me një procedurë që për Albcontrol sh.a është shumë e rëndësishme është kërkuar prezenca në stafin e operatorit

ekonomik për të paktën 3-muaj që është dhe periudha minimale e parashikuar në Kodin e Punës si periudhë prove për një punonjës.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

Njësia e Prokurimit

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, pjesë e Dokumentave të Tenderit (D.T.) ngarkuar në S.P.E. e A.P.P., për shërbimet objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të L.P.P., si dhe nenit 41, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të L.P.P.. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e Prokurimit

SPECIFIKIME TEKNIKE

HYRJE

Në kuadër të ofrimit të shërbimeve ATS, AFISO dhe CNS në Aeroportin e Kukësit, lind nevoja për marrjen me qira të infrastrukturës CNS sipas Planit të Biznesit të Kompanisë dhe vendimit Menaxherial.

Aktualisht, në këtë aeroport është duke operuar në të njëjtin model biznesi një kullë mobile me të gjitha pajisjet CNS të nevojshme për ofrimin e këtij shërbimi. Në këtë rast, Albcontrol do të shfrytëzojë sistemet CNS të instaluar për të plotësuar kërkesat e Divizionit Operacional, nga i cili ka marrë dhe kërkesat e nevojshme për këtë kullë.

Konfidencialiteti

I gjithë Informacioni i marrë nëpërmjet kësaj procedure është pronë e Albcontrol dhe ofertuesit nuk mund ta përdorin apo shpërndajnë tek të tretë përveçse për nevojat e përmbushjes dhe plotësimit të ofertës së tyre.

Po kështu oferta e dorëzuar në Albcontrol do të trajtohet si konfidenciale dhe nuk do të shpërndahet tek të tretë jashtë Albcontrol-it.

1. Të Përgjithshme

Në përmbajtje të këtij dokumenti të Specifikimeve Teknike, Albcontrol duhet të sigurojë vijueshmërinë e punës, rritjen e performancës së tij, ruajtjen e nivelit të SAFETY dhe plotësimin e standardeve të ICAO-s, EASA në Aeroportin e Kukësit.

Kompania do të ofrojë sisteme të Çertifikuara nga Prodhues të njohur Europianë së bashku me dokumentet përkatëse të Interoperabilitetit, Declaration of Conformity.

Ofruesi i Infrastrukturës TWR Kukës duhet të ofrojë gjithashtu një sasi të nevojshme pjesë rezerve të depozituara në site (LRU, local unit replacement) e cila do të zvogëlojë kohën e sjelljes në punë në rast defektesh.

Në zëra kërkesash parashikohet të ofrohet si më poshtë:

1. Furnizim TWR, i cili do merret me qira me të gjitha sistemet e kërkuara në listën e detajuar në brendësi të këtij dokumenti.
2. Furnizim pjesësh rezerve të ruajtura në site.
3. Instalimi dhe komisionimi i kullës dhe pjesëve përbërëse të saj.
4. Mirëmbajtja e pjesëve elektro-mekanike, kondicionim dhe sistemi i zjarrit për periudhën e marrjes me qira.
5. Suport nga prodhuesit e sistemeve CNS, VHF Radio A-G, Central Telefonik, Crash Phone gjatë integritetit të sistemeve me sistemet aktuale të Albcontrol.

1.1 Gama e Furnizimit

Ofertuesit do të ofrojnë shërbimet si vijon:

A- Hardware

1. Furnizim **TWR** me të gjitha sistemet e kërkuara në listën e detajuar në brendësi të këtij dokumenti.
2. Furnizim pjesësh rezerve të ruajtura në **site**.

B- Shërbime

- 1 Instalim dhe komisionim i kullës dhe pjesëve përbërëse të saj.
- 2 Mirëmbajtja e pjesëve elektro-mekanike, kondicionim dhe sistemi i zjarrit.
- 3 Suport nga prodhuesit e sistemeve CNS, VHF Radio A-G, Central Telefonik, Crash Phone gjatë integritetit të sistemeve me sistemet aktuale të Albcontrol.

2. Kërkesat teknike për Kullën dhe sistemet përbërëse të saj	
2.1. Kërkesa teknike për pjesën kabinës së kullës	
Nr i specifikimit	Specifikimi
2.1.1	Kulla duhet të jetë e ndërtuar në kontenier, i cili të jetë vendosur mbi një trailer, si dhe e pajisur me ngritës hidraulik, si dhe sistem bllokimi të ngritjes kur kulla pozicionohet për përdorim.
2.1.2	1- Kulla duhet të jetë e ndërtuar në formën e një kontenieri ISO-1C dhe: 2- Paretët dhe çatia duhet të jenë të ndërtuara me material që absorbon zhurmat. 3- Çatia duhet të ketë pozicionet e duhura për montimin e antenave të radiove VHF. 4- Dyshemeja duhet të jetë antistatike
2.1.3	Kulla duhet të ketë: 1- Ballkon i cili duhet të ketë edhe pozicionimin e shkallëve për tu ngjitur në kullë 2- Duhet të ketë shkallë të çmontueshme, të cilat vendosen vetëm gjatë përdorimit të kullës.
2.1.4	Dritaret e Kullës duhet të kenë karakteristikat si më poshtë 1- Të kenë mundësi që të mbulohen gjatë transportit. 2- Xhami i përdorur duhet të jetë që të durojë zhurmat e nivelit të shpërthimeve, si dhe të ketë mbrojtje nga papastërtitë, si dhe njollat e krijuara nga pikat e ujit. 3- Dritaret duhet të jenë të pajisura me perde.
2.1.5	Konsola brenda në kullë: 1- Konsola duhet të suportoje deri në 2 (dy) poste pune për kontrollor. 2- Duhet të ketë vendet e nevojshme për montimin e pajisjeve ATC në formatin 19" 3- Duhet të ketë dy karrige të levizshme 4- Orë digjitale për të shfaqur orën në UTC. 5- Orë digjitale për të shfaqur orën lokale
2.1.6	Ndriçimi i kullës - a- Kulla duhet të jetë e pajisur me ndriçim të brendshëm me ngjyra, për t'u përdorur në varësi të kohës dhe situatës. - b- Ndriçim Natyral - c- Ndriçim blu për natën - d- Ndriçim Emergjent - e- Ndriçim i jashtëm 1- Gjithashtu, kulla duhet të jetë e pajisur me ndriçim për të treguar lartësitë (Obstruction Light).

2.1.7	Furnizimi me Energji i Kullës: 1- Kulla duhet të ketë mundësi të furnizohet me tension 3-fazor 400V. 2- Duhet të ketë panel shpërndarjeje të energjisë, të pajisur me mbrojtëse diferenciale dhe magnetotermike. 3- Kulla duhet të ketë një UPS i cili duhet të mbajë pajisjet ATC në gjendje pune për një periudhë kohore jo më të vogël se 1 orë.
2.1.8	Mbrojtja dhe siguria e kullës 1- Kulla duhet të jetë e pajisur me sistem rrufeprerës dhe me kabllimet dhe pjesët përbërëse të rufeprerës. 2- Duhet të jetë e pajisur me sistem detektimi të zjarrit dhe alarm. 3- Duhet të ketë shuarës të zjarrit.
2.1.9	Paisje te tjera qe duhet të ketë kulla: 1- Kondicionim te Kontenierit 2- Light Gun 3- Kutitë ndihmës së shpejtë
2.1.10	Konsola e kullës duhet të ketë: 1- Ekranet me ndriçim të lartë për të shfaqur të dhënat e ATC si AFTN, AWOS etj. 2- Duhet të jetë e pajisur me ndriçim lokal në çdo post, i komandueshëm dhe dimërueshëm.
2.2. Kërkesa teknike për Sistemet ATC të përfshira në kullë	
2.2.1	Sistemi i komunikimit A-G dhe G-G (Postet e Punes): 1- Kulla duhet të jetë e pajisur me dy poste pune për kontrollorë, për komandimin dhe përdorimin e komunikimeve A-G dhe G-G. 2- Komunikimet A-G dhe G-G duhet të komandohen nëpërmjet ekraneve me prekje me madhësi 10". 3- Nga këto ekrane kontrollori do të ketë mundësi të selektojë radion VHF që mund të përdorë, si dhe të realizojë thirrjet telefonike. 4- Panelet duhet të kenë mundësi të lidhen me radiot VHF lokale në kullë nëpërmjet protokollit VOIP. 5- Panelet duhet të kenë mundësi të lidhen me Albcontrol (Rinas, Tiranë) nëpërmjet protokollit SIP. 6- Postet e punës duhet të jenë të pajisur me altoparlante, si dhe fisha për të përdorur kufje gjatë komunikimit.
2.2.2	Sistemi i komunikimit A-G dhe G-G (Radiot VHF): 1- Kulla duhet të jetë e pajisur me minimumi Radio TRX në bandën VHF të Aviacionit. 2- Kulla duhet të jetë e pajisur me minimumi Radio TRX në bandën VHF të Aviacionit. 3- Radiot duhet të jenë të pajisura me antenat e veta, të cilat duhet të jenë të montuara në çatinë e kullës. 4- Kulla duhet të ketë dhe një radio TRX stand-alone për raste emergjente, kur konsola nuk është

	funkionale. Kjo radio duhet të ketë furnizim të veçantë me ushqim dhe bateri.
2.2.3	Sistemi i komunikimit A-G dhe G-G (Crash Phone): 1- Kulla duhet të jetë e pajisur me një sistem të pavarur për njoftimin e zjarrfikësve dhe Menaxhimit të Aeroportit në rast të incidenteve në Aeroport. 2- Sistemi Crash Phone duhet të jetë i pajisur me setin e kullës dhe setin e zjarrfikësve, si dhe komunikimi mes kullës dhe zjarrfikësve do të bëhet nëpërmjet linjave telefonike ekzistuese. 3- Ky sistem, në stacionin e zjarrfikësve, duhet të jetë i pajisur me një sirenë dhe bokse për të dhënë alarm në momentin kur kontrollori do të njoftojë për incidente.
2.2.4	Sistemi i regjistrimit zanor 1- Kulla duhet të jetë e pajisur me një sistem regjistrimi të komunikimeve zanore. 2- Ky sistem duhet të ketë mundësinë e ruajtjes së informacionit audio për një periudhë jo më të vogël se 30 ditë. 3- Sistemi duhet të ketë mundësinë që të aksesohet remote nga Qendra e Albcontrol (Rinas). 4- Sistemi i regjistrimit duhet të regjistrojë radiot VHF, telefoninë, Crash Phone dhe radion e emergjencës. 5- Sistemi i regjistrimit zanor do të jetë i pajisur edhe me regjistrim të ambientit. Ky regjistrim duhet të ruhet për të paktën 24 orë, bazuar në kërkesat e rregullores së EASA 2017/373 - ATS.OR.460.
2.2.5	Sisteme të tjera: 1- Kulla duhet të ketë një monitor minimum 19" për të shfaqur të dhënat meteorologjike nga sistemi AWOS 2- Këto monitore duhet të jenë të montuar në konsole, dhe vetë konsola duhet të ketë hapësirë për të montuar kompjuterët e këtyre sistemeve në të.
2.2.6	Sistemi Meteorologjik portabel për matjen dhe vizualizimin e parametrave të erës, drejtimit, forcës, temperaturës, presionit atmosferik. Sistemi duhet të jetë me certifikatë kalibrimi, apo i dizenuar për autokalibrim në bazë të një procedure të deklaruar që kryhet nga Kontraktori.
3. Sherbimet	
3.1. Instalimi dhe Komisionimi i Kullës	
2.3.1	Kontraktori duhet të realizojë pozicionimin e kullës në vendin e caktuar, si dhe instalimin e saj. 1- Duhet të sigurojë dhe kryejë lidhjen elektrike me rrjetin elektrik të aeroportit. 2- Duhet të sigurojë dhe kryejë lidhjen e linjave

	telefonike dhe të të dhënave që vijnë nga jashtë kullës. 3- Duhet të kryejë instalimin e plotë të të gjitha pjesëve përbërëse të kullës, si antena, Obstruction Light dhe mbrojtjen nga rrufeja.
2.3.2	Kontraktori pas instalimit duhet të bëjë komisionimin e kullës, ku duhet të testohen sistemet përbërëse të saj: 1- Testimin e sistemit elektro-mekanik. 2- Testimin e sistemit elektrik. 3- Testimin e sistemeve ATC (sistemet A–G, G–G, regjistruar etj.).
3.2. Mirembajtja e Kullës	
3.2.1	Kontraktori duhet të këshillojë dhe të realizojë mirëmbajtjen periodike të pjesëve mekanike dhe elektromekanike të kullës.
3.2.2	Gjatë periudhës së mbajtjes me qira të kullës, kontraktori duhet të kryejë shërbime periodike të mirëmbajtjes së sistemeve si më poshtë: 1- Sistemit elektrik të kullës dhe UPS. 2- Sistemit të kondicionimit. 3- Sistemit të mbrojtjes nga zjarri. 4- Gjendjes fizike të kontenierit.
3.2.3	Për çdo mirëmbajtje që do të kryhet nga Kontraktori, pas kryerjes së saj ai duhet të paraqesë një raport të detajuar të mirëmbajtjes. Ky raport do të ketë një format të caktuar, dhe për formatin do të bihet dakord me stafin teknik të Albcontrol.
3.2.4	Gjatë 6-mujorit të parë të kontratës së qirasë, kontraktori duhet t'i bëjë një kontroll të detajuar sistemeve ATC të montuara në kullë (sistemet A–G, G–G, regjistruar etj.). Ky kontroll duhet të kryhet nga prodhuesi i pajisjeve. Mbas kontrollit, kontraktori dhe prodhuesi duhet të lëshojnë një raport të detajuar për kontrollin e kryer.
3.3. Suporti nga prodhuesi	
3.3.1	Kontraktori duhet të sigurojë suportin e prodhuesit për të gjitha sistemet ATC përbërëse të kullës.
3.3.2	Gjatë instalimit dhe komisionimit, kontraktori duhet të

	sigurojë suportin nga prodhuesi për sistemet ATC. 1- Suporti duhet të përfshijë personel në stacion ose remote, i cili do të ndihmojë në integrimin e sistemeve të kullës me sistemet ekzistuese të Albcontrol.
3.3.3	1- Kontraktori është përgjegjës për mbajtjen në punë të sistemeve COM në terren, duke garantuar suportin nga prodhuesit dhe një sasi të nevojshme pjesë rezerve për të suportuar qëllimin për sistemet që do të vendosen në dispozicion si pjesë e kontratës së qeramarrjes.

Shtojca A: Lista e pajisjeve dhe shërbimeve

Nr.	Pershkrimi pjeseve/sherbimeve	Njesia	Sasia	Koha e kryerjes
A	Kulla me qira			
1	Kulla dhe sistemet COM dhe MET me qira	Muaj	12	
2	Mirëmbajtja e pjesëve elektro-mekanike.	Periodik	4	
3	Mirëmbajtja e sistemeve ATC.	Periodik	1	